

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

463
Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 05.02.2024

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.04

Datë: 31.01.2024

“Për miratimin e nivelit të qerasë mesatare në treg të lirë, sipas strukturave të apartamenteve”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





463/108/02/24

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.126/1 prot.

Peshkopi, më 07.02.2024

Lënda : Për vendimin nr.04, datë 31.01.2024 të Këshillit të Bashkisë Dibër

BASHKISË DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pas verifikimit të ligjshmërisë së vendimit të Këshillit të Bashkisë Dibër nr.4, datë 31.01.2024 "*Për miratimin e nivelit të qerasë mesatare në treg të lirë, sipas strukturave të apartamenteve*", vendosa ;

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën përkatëse, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të bashkisë Dibër që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 04 Datë 31 / 01 /2024

“PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË,
SIPAS STRUKTURAVE TË APARTAMENTEVE”

Mbështetur në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, nga Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **31.01.2024** me 24 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

1. Miratimin e nivelit të qirasë mesatare të apartamenteve në treg, për efekt subvencionimi të qirasë, me ndryshimet e propozuara nga këshilltarët për pikën 1/b nga vlera **12,000-15,000** në vlerën e mëposhtme:

a) Për apartament të tipit “Garsonierë”	<u>6,000</u>	lekë/muaj
b) Për apartament të tipit 1+1	<u>14,000 – 17,000</u>	lekë/muaj
c) Për apartament të tipit 2+1	<u>15,000 – 18,000</u>	lekë/muaj
d) Për apartament të tipit 3+1	<u>18,000 – 22,000</u>	lekë/muaj

- Miratimin e vlerës të qirasë vjetore për vitin 2024, për apartamentet e programit “Banesë sociale me qira”, me vlerën 88 lekë/m² në muaj;
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit, Bashkia Dibër;
- Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit, Qarku Dibër.
- Vendimi u shpall me datë **31.01.2024**.

Kryetare e Këshillit Bashkiak

Irimi Shetku





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR
DREJTORIA JURIDIKE, PROKURIMEVE DHE PRONAVE
SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË PRONAVE DHE STREHIMIT

PROJEKT - VENDIM

Nr. 02, datë, 22.01.2024

**“PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË,
SIPAS STRUKTURAVE TË APARTAMENTEVE”**

Mbështetur në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit në mbledhjen e Këshilit Bashkiak të datës, ____ .01.2024

PROPOZON

1. Miratimin e nivelit të qirasë mesatare të apartamenteve në treg, për efekt subvencionimi të qirasë:

a) Për apartament të tipit “Garsonierë”	6,000	lekë/muaj
b) Për apartament të tipit 1+1	12,000 – 15,000	lekë/muaj
c) Për apartament të tipit 2+1	15,000 – 18,000	lekë/muaj
d) Për apartament të tipit 3+1	18,000 – 22,000	lekë/muaj

2. Miratimin e vlerës të qirasë vjetore për vitin 2024, për apartamentet e programit “Banesë sociale me qira”, me vlerën 88 lekë/m² në muaj;


3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit, Bashkia Dibër;

4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e institucionit të Prefektit, Qarku Dibër;

**Përgjegjës i Sektori të
Administrimit të Pronave
dhe Strehimit**
Gazmend Miftari

Drejtori Juridik

Ismet Saragi



Date _____._____.2024


**RELACION
PER PROJEKT VENDIMIN
PËR**


**“ MIRATIMIN E NIVELIT TE QIRASE MESATARE NE TREG TE LIRE SIPAS
STRUKTURAVE TE APARTAMENTIT ”**

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenin 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 77, pika 10, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Vendimin nr. 814, datë 03.12.2004, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, vendimin nr. 574, datë 29.08.2012, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, VKM Nr. 362_date 29.05.2019_Per kriteret e dhenies se subvencionit te qirase per kategorite qe gezojne perparesi ne subvencionimin e qirase ne tregun e lire, ky projekt vendim bazohet ne nenin 73 të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, pik 2 germa (dh) ku citohet : Brenda muajit janar të çdo viti, njesia vendore paraqet pranë ministrit përgjegjës për strehimin kërkesën për financime, investime dhe subvencione, sipas këtij ligji, nga fondet e buxhetit të vitit korrent, shoqëruar me informacionin, i cili përmban:

- numrin e familjeve të regjistruara për t’u trajtuar me programet sociale të strehimit;
- numrin e familjeve që janë trajtuar brenda një viti;
- nivelin e qirasë së miratuar me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Punoi:

Specialist strehimi Mentor Bitri 

Juriste. Xhesika Rama 

Pranoi :

P/ Sektorit te Pronave dhe Strehimit

Gazmend Miftari 